

FTESE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË ZBATIMIN E AKTIVITETEVE NË DREJTORIN E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE



1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS) e Komunës së Gjakovës u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së së Komunës së Gjakovës i cili i dedikohet sektorëve të personave me nevojë të veqanta.

2. OJQ-te në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte të/ programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

1. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës programi i të cilëve është i fokusuar në integrimin e personave të verbër dhe shurdhmemec.

2. Të gjitha OJQ-të, Shoqatat e Komunës së Gjakovës, programi i të cilave është i fokusuar në mbështetjen e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe Shoqatat e ndryshme me karakter humanitar.

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me projektet që kontribuojnë në zbatimin, promovimin dhe përmirësimin e fokus grupeve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale përmes aktiviteteve si më poshtë:

- ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile, në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me nevojë të veqanta, implementimin e programeve të tyre në kuadër të DSHMS-së;
- ✓ Mbeshtetja e aktiviteteve të përgjithshme të edukimit joformal për fushat e OJQ-ve të cilat i ofrojnë në kuadër të DSHMS-së;
- ✓ Aktivitetet që synojnë adresimin e problemeve specifike me prioritet duke përfshirë arsimin, politikën sociale, shërbime shëndetësore dhe fusha tjera të ngjashme;
- ✓ Aktivitetet lidhur me shërbimet e rehabilitimit, socializimit, të personave me aftësi të kufizuara, të personave me nevojë të veqanta, dhe fusha tjera të ngjashme si këto në kuadër të DSHMS-së;

4. Vlera totale planifikuar e thirrjes dhe mbështetjes është 11,000.00 Euro

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për këto projekte individuale është 500,00 Euro, ndërsa shuma maksimale për këto projekte nuk do të kalojë vlerën e 2,000.00 Euro.

5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën: 17.07.2018-07.08.2018

6. OJQ-te mund të aplikojnë me më shumë dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë partnerë në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

Të drejte aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ e regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës, së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës, është i fokusuar në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.



FTESE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË ZBATIMIN E AKTIVITETEVE NË DREJTORIN E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

OJQ duhet poashtu të kenë të kryera transakcionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-te duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës i OJQ-se, dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ka zgjidhur çdo qeshtje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të paguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e parapare, të cilat së bashku me Udhëzimet për Plikantë janë në dispozicion në faqen e internetit (<https://kk.rks-gov.net/gjakova/>), si dhe mund të marrin personalisht në zyrat e DSHMS-së

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në adresën e mëposhtme:

Adresa: Rr. "Nene Tereza" Nr 469, 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyrat e DSHMS-së në Kuvendin e Komunës.

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve e programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në zhvillimin dhe avancimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlersimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajizuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha qeshtjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DSHMS-së

Gjakovë, 17-07-2018

Adelina Shehu-Kola Drejtoreshë e DSHMS-së

Nënshkrimi

